



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE FIER

Nr. \_\_\_\_/\_\_\_\_Prot.

Fier, më 05.04.2023

**Lënda:** Formulari i njoftimit paraprak të fituesit për procedurën me objekt **“Blerje beton M.150 dhe M.200”**(*Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik fitues, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 24 muaj*), me burim financimi nga Buxheti i Ndermarrjes se Sherbimeve Publike Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK  
TIRANË  
(për botim)

**Shtojca 10**

**NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE FIER**

**Data:** 05.04.2023

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik **“GENERAL BETON” SHPK**

**Adresa:** Fier Patos PATOS Rruga Fier- Patos km.5, kthesa e Patosit, zona kadastrale me nr.2890, nr.pasurie 59/14, kantier ndertimi perballe Alb Star.

**K23013401A**

**\* \* \***

Procedura e prokurimit: E hapur me mjete elektronike, me objekt **“Blerje beton M.150 dhe M.200”**(*Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik fitues, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 24 muaj*),

**Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-61400-03-06-2023.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje beton M.150 dhe M.200”**(*Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik fitues, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 24 muaj*), me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej **17 790 000** (*shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë*) **lekë pa TVSH**, me burim financimi nga Buxheti i Ndermarrjes se Sherbimeve

Publike Fier , në perputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **24 (njëzetë e katër) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [13 Mars 2023], [Numri 24].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- Operatori ekonomik GENERAL BETON SHPK me NUIS K23013401A.  
Vlera totale sipas formularit të ofertës është **15 450 000** (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
- Operatori ekonomik LLAZO SHPK me NUIS K24218401K.  
Vlera totale sipas formularit të ofertës është **15 450 000** (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

**O.E “LLAZO” SHPK me NUIS K24218401K** skualifikohet per arsye se:

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, të operatorit ekonomik LLAZO SHPK, me NUIS K24218401K, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Bazuar në dokumentat standarte të tenderit për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit operatori ekonomik duhet të përmbushë kriterin si më poshtë:

## **“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **2.3Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** *Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se 7 000 000 lekë pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.*

*Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:*

- a-** *Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasitë e mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasitë e mallrave të furnizuara*

**ose**

- b- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, te plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”*

Bazuar në dokumentacionin e ngarkuar në SPE(sistemi elektronik i prokurimeve), për përmbushjen e këtij kriteri nga Operatori ekonomik “LLAZO” SHPK, janë paraqitur përkatësisht faturat tatimore elektronike shitjeje për furnizimet e mëparshme të ngjashme, vlerë e cila është më e vogël se vlera e kërkuar sipas DST, prej jo më pak se **7 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Nga faturat tatimore të shitjes, gjithësej 82 fatura të paraqitura, tre prej tyre, përkatësisht:

- Fatura tatimore nr. 18/2023, datë 30.01.2023, përshkrimi: çinstalim/instalim autopompe;
- Fatura tatimore nr. 80/2023, datë 09.02.2023, përshkrimi: çinstalim/instalim autopompe;
- Fatura tatimore nr. 171/2023, datë 07.03.2023, përshkrimi: hekur;

nuk kanë në objektin e tyre furnizime për mallra të ngjashme me objektin që prokurohet.

Pra, vlera totale e faturave të shitjes të hedhura në SPE nga ana e Operatorit Ekonomik LLAZO SHPK nuk e arrinë vlerën e kërkuar prej jo më pak se 7 000 000 lekë pa TVSH që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës sipas DST-së.

KVO vlerëson se nga ana e OE nuk plotësohet kriteri i veçantë i kualifikimit 2.3.1 sipas DST-së lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme, duke përbërë shkak për skualifikimin e ofertës së tij.

**Pra, vlera totale e faturave të shitjes të hedhura në SPE nga ana e OE “LLAZO” SHPK nuk e arrinë vlerën e kërkuar prej jo më pak se 7 000 000 lekë pa TVSH që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës duke bërë shkak për skualifikim.**

**\*\*\***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**GENERAL BETON**” SHPK, numri i NUIS: **K23013401A**, me adrese: *Fier Patos PATOS Rruga Fier- Patos km.5, kthesa e Patosit, zona kadastrale me nr.2890, nr.pasurie 59/14, kantier ndertimi perballe Alb Star*, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **15 450 000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH** dhe prej **18 540 000 (tetëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet mijë) lekë me TVSH**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Ludovik TARAJ**